



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQESISE, PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive	
Nr./Br./No.	3215
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	1+10+10+10
Data/Datum/Date:	26.08.2024
PRISHTINE PRISTINA PRISTINA	

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) -NR.13/2024
PËR VLERËSIMIN DHE KOMPENSIMIN E KAFSHËVE TË
ASGJËSUARA PËR SHKAK TË SËMUNDJEVE INFEKTIVE

¹ Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 13/2024 për vlerësimin dhe kompensimin e kafshëve të asgjësuara për shkak të sëmundjeve infektive i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me Vendim me Ref. KM-250/24 të datës 10.07.2024.

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Në mbështetje të nenit 9, paragrafi 9.1, 9.2, (b) 9.3 dhe 9.4, neni 10 paragrafi 10.2 të Ligjit Nr.2004/21 Për Veterinarinë, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/01 Nëntor 2007), neni 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.34/18 Nëntor 2022) si dhe neni 9 paragrafi 2 të Rregullores (QRK)- Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (21.06.2024),

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR. 13/2024
PËR VLERËSIMIN DHE KOMPENSIMIN E KAFSHËVE TË ASGJËSUARA PËR SHKAK TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ, përcaktohet vlera e kompensimit të dëmit për asgjësimin e kafshëve të gjalla të cilat asgjësohen për shkak të sëmundjeve infektive të përcaktuara sipas listës së sëmundjeve nga Programi i Pare dhe Programi i Dytë të Ligjit Nr.2004/21 për Veterinarinë.

Nenin 2

Fushëveprimit

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të detyrueshme për zbatim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe të gjithë veterinarët zyrtar si dhe të gjithë personat që marrin pjesë në procesin e kompensimit të dëmit për asgjësimin e kafshëve të gjalla të cilat asgjësohen për shkak të sëmundjeve infektive.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime:

1.1. **Ministria** nënkupton Ministrinë përgjegjëse për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural;

1.2. **AUV** nënkupton Agjencinë përgjegjëse për Ushqim dhe Veterinari;

1.3. **Person** nënkupton personin fizik dhe juridik

2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ e kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç janë të përcaktuar në Ligjin Nr.2004/21 për Veterinarinë.

Neni 4

Therja e detyrueshme e kafshëve

1. Me qëllim të sigurimit të parandalimit, kontrollit dhe çrrënjësjes së sëmundjeve infektive të kafshëve të dhëna në Listës nga Programi i parë dhe i dytë të Ligjit Nr. 2004/21 Për Veterinarinë, kafshët e vërtetuara si të infektuara do të theren nën kontrollin e veterinarit zyrtar.

2. Në rast të shpërthimit të ndonjë sëmundje nga lista e Programit të Parë, AUV definon zonat e mbrojtura dhe të vëzhguara si dhe pronarët e kafshëve marrin kontribute financiare prej AUV për çrrënjësin e sëmundjes, siç mund të vendos Ministri për çdo rast të veçantë, varësisht prej kushteve prej të cilave përbëhen masat e zbatuara, e së paku, izolimi i pronës nga koha e dyshimit për prezencën e sëmundjes e deri te konfirmimi zyrtar i ekzistencës së sëmundjes si dhe:

2.1. AUV urdhëron therjen e dhunshme të llojeve të kafshëve të prekshme nga sëmundjet, të cilat janë prekur ose kontaminuar ose të dyshuara se janë prekur ose kontaminuar, dhe shkatërrimin i tyre;

2.2. AUV urdhëron shkatërrimin e ushqimeve të kontaminuara dhe pajisjeve të kontaminuara, në rastet kur artikujt e kontaminuar nuk mund të dezinfektohen në pajtim me këtë nen, dhe

2.3. AUV urdhëron pastrimin, dezinfektimin, desinsektimin dhe deratizimin e pronave dhe të pajisjeve në ato prona.

Neni 5

Kompensimi i dëmit

1. Pronarit të cilit i janë therr, përkatësisht i janë asgjësuar kafshët për shkak të sëmundjeve infektive si:

1.1. të cilat janë eliminuar për arsye se kanë rezultuar pozitiv për sëmundje infektive gjatë gjurmimeve diagnostikuese të ushtruara nga shërbimi veterinar rajonal në zbatim të programit shtetëror të masave profilaktike veterinare, pas testimeve në terren dhe në bazë të rezultateve të analizave të kryera në laboratorët e autorizuar ose në laboratorin e Ushqimore dhe Veterinarisë;

1.2. kanë ngordhur si pasojë e zbatimit nga shërbimi veterinar rajonal i masave të programit shtetëror të profilaksisë veterinare;

1.3. kanë ngordhur si pasojë e një sëmundje kontrolli i së cilës mbështetet;

1.4. kafshët e therura në thertore për konsum publik të konstatuara nga inspektori veterinar, kafshët e therura të konstatuara nga veterinari në bazë të shenjave karakteristike të sëmundjes dhe të konfirmuara edhe nga inspektori veterinar-AUV, pa analiza laboratorike vetëm me Procesverbal dhe foto nga vendi i ngjarjes.

2. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, i bënë kompensimin për kafshët e asgjësuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për kafshët e llojit të:

2.1. gjedhit të infektuara nga: TBC, TSE, Bruceloza, Leukoza, Enzotike e Gjedhit, Afta Epizotike dhe Antraksi;

2.2. deleve dhe dhive të infektuara nga: Bruceloza, Antraksi, Afta Epizotike dhe TBC;

2.3.derrave të infektuara nga: Mortaja Klasike e Derrave, Mortaja Afrikane e Derrave;

2.4.shpezëve të infektuara nga: Mortaja Atipike e Shpezëve dhe Gripi i Shpendëve, dhe

2.5.bletëve - koshereve të infektuara nga: Mortaja Amerikane dhe Evropiane e Bletëve.

II – VLERËSIMI DHE KOMPENSIMI I DËMIT

Neni 6

Kompensimi i dëmit për kafshët e llojit të gjedhit

1. Pronarit të kafshës së llojit të gjedhit, i takon kompensimi i dëmit për kafshët e therura, përkatësisht asgjësuar, të vërtetuara si të infektuara nga sëmundja nga neni 5 paragrafi 2, të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Lartësia e kompensimit të dëmit për kafshët e llojit të gjedhit të vërtetuara me sëmundjet infektive nga neni 5 paragrafi 2, të këtij Udhëzimi Administrativ, caktohet sipas racës, gjinisë dhe moshës në përputhje me lartësinë e vlerës së kompensimit të përcaktuar në Tabelën 1, të këtij Udhëzim Administrativ.

3. Për kompensimin e buallicave të asgjësuar si pasojë e sëmundjeve infektive zbatohet vlera e kompensimit të përcaktuar në tabelën e mëposhtme për kafshët e racës fisnike, duke i respektuar të dhënat për moshën dhe gjininë të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela Nr. 1

Meshkuj				Femra			
Mosha	Vlera e kompensimit në euro			Mosha	Vlera e kompensimit në euro		
	Raca Bushe	Racate përzierë	Racat Fisnike		Raca Bushe	Racate përzierë	Racat Fisnike
Deri në moshën 3 muaj	300€	350€	450€	Deri në moshën 3 muaj	300€	350€	420€
Nga 4 muaj deri në 6 muaj	460€	550€	700€	Nga 4 muaj deri në 6 muaj	450€	550€	700€
Nga 7 muaj deri në 9 muaj	650€	800€	1000€	Nga 7 muaj deri në 9 muaj	650€	750€	850€
Nga 10 muaj deri në 12 muaj	750€	900€	1250€	Nga 10 muaj deri në 12 muaj	700€	900€	1200€
Nga 13 muaj deri në 16 muaj	1000€	1250€	1500€	Nga 13 muaj deri në 16 muaj	900€	1100€	1400€
Nga 17 muaj deri në 20 muaj	1100€	1300€	1700€	Nga 17 muaj deri në 20 muaj	1000€	1200€	1600€
Nga 21 muaj deri në 36 muaj	1200€	1400€	1750€	Nga 21 muaj deri në 84 muaj	1000€	1500€	1700€
Nga 37 muaj	1100€	1300€	1600€	Nga 85 muaj	900€	1250€	1550€

Neni 7
Kompensimi i dëmit për kafshët e llojit të deleve dhe dhive

1. Pronarit të kafshës së llojit të deleve dhe dhive, i takon kompensimi i dëmit për kafshët e therura përkatësisht asgjësuar, të vërtetuara si të infektuara nga sëmundja nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Lartësia e kompensimit të dëmit pronarit të kafshëve të llojit të deleve dhe dhive, nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, të këtij Udhëzimi Administrativ, bëhet në përputhje me lartësinë e vlerës së kompensimit sipas moshës siç është përcaktuar në tabelën 2, të këtij Udhëzimi Administrativ.

Tabela nr.2

Delet	Vlera e kompensimit
0-2 muaj	40€
3-6 muaj	60€
7-12 muaj (pjellja e parë)	90€
Mbi 12 muaj	120€
Dhitë	Vlera e kompensimit
0-2 muaj	40€
3-6 muaj	60€
7-12 muaj (pjellja e pare)	90€
Mbi 12 muaj	115€

Neni 8
Kompensimi i dëmit për kafshët e llojit të derrit

1. Pronarit të kafshës të llojit të derrit i takon kompensimi i dëmit për kafshët e therura, përkatësisht asgjësuar, të vërtetuara si të infektuara nga sëmundja nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.3, të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Lartësia e kompensimit të dëmit nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.3, të këtij Udhëzimi Administrativ është e përcaktuar sipas moshës dhe është e paraqitur në tabelën 3, të këtij Udhëzimi Administrativ.

Tabela Nr. 3.

Derrat	Vlera e kompensimit
0-2 muaj	50€
3-6 muaj	80€
Mbi 6 muaj	120€

Neni 9
Kompensimi i dëmit për kategorinë e shpezëve

1. Pronarit të llojit të shpezëve, i takon kompensimi i dëmit për shpezët e therura, përkatësisht asgjësuarat të vërtetuara si të infektuara nga sëmundjet nga neni 5, paragrafi 2, nënparagrafi 2.4, të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Lartësia e kompensimit të dëmit nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.4, të këtij Udhëzimi Administrativ, është e përcaktuar sipas moshës dhe është e paraqitur në tabelën 4 dhe tabelën 4.1, të këtij Udhëzimi Administrativ.

Tabela Nr. 4.

Kategoritë e Shpezëve	Çmimi në euro
Zogjtë një ditor (brojler/vojte)	1€
Zogëza 18 javëshe	6.5€
Zogj brojler deri në 7 javë	3.5€
Pula vojse deri në 12 muaj	5.5€
Pula vojse mbi 12 muaj	1.5€

Tabela 4.1 Shpezët e llojeve të tjera në ekonominë familjare /komerciale

Qura (Biba)	25€
Zogjë qurë(Bibe)	3.5€
Gusa (Rosa)	18€
Zogjë guse (Rose)	3.5€
Pata (Shota)	15€
Zogjë pate (Shote)	5€
Pëllumbat	10€
Pula	14€
Zogjë pule	2.5€
Shpezët e llojeve të tjera	5 €

Neni 10

Kompensimi i dëmit për bletë

1. Pronarit të llojit të bletëve, i takon kompensimi i dëmit për bletët e asgjësuarat vetëm për shoqëritë të cilat janë prezentë në koshere, kanë shenja klinike të sëmundjes dhe të vërtetuara si të infektuara nga sëmundja nga neni 5, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5, të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Lartësia e kompensimit të dëmit pronarit të llojit të bletëve bëhet për koshere të bletëve, dhe është paraqitur në tabelën 5, të këtij Udhëzimi Administrativ.

Tabela nr. 5

Bletë (për koshere)	Çmimi në euro
Shoqëri - koshere bletësh njëkatëshe	140€
Shoqëri – koshere bletësh dykatëshe	170€
Shoqëri - koshere bletësh me mbi dy e më shumë kate	180€

Neni 11

Kompensimi për kuaj dhe gomar/mushka

Kompensimit pronarëve të kafshëve të llojit kuaj dhe gomar/mushka bëhet sipas moshës, në përputhje me lartësinë e vlerës së kompensimit të përcaktuar në tabelën 6, të këtij Udhëzimi Administrativ.

Tabela nr. 6.

Kuaj	Çmimi ne euro
0-3 muaj	100 €
4-12 muaj	250 €
Mbi 12muaj	400 €
Gomare/Mushk	Çmimi ne euro
0-3 muaj	80 €
4-12 muaj	150 €
Mbi 12 muaj	200 €

III. BURIMET FINANCIARE

Neni 12

Mjetet financiare

Shuma e kompensimit për therje të detyrueshme të kafshëve të dyshuara ose të konfirmuara si të infektuara si dhe metodat për hedhjen dhe asgjësimin e sigurve të trupave të tyre sigurohet nga burimet financiare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Neni 13

Mënyra e kompensimit të dëmit

1. Lartësia e kompensimit të dëmit për kafshët e infektuara- asgjësuar të cilat janë të përfshira në këtë Udhëzimi Administrativ janë përcaktuar në tabela, varësisht nga lloji i tyre.
2. Kafshët për të cilat në bazë të legjislacionit në fuqi, therja-asgjësimi është i detyrueshëm për shkak të sëmundjeve infektive të tyre kompensohen nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, sipas tabelave të këtij Udhëzimi Administrativ.
3. Kompensimi bëhet me vendim të veçantë të cilit i bashkëngjitet edhe vlerësimi i dëmit nga ana e komisionit për vlerësim dhe dëshmitë tjera si procesverbali fotot nga vendi i asgjësimit, të dhënat personale të pronarit të kafshës si dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm.

Neni 14

Tabela e vlerësimit

1. Tabelat e vlerësimeve në nenet 6, 7, 8, 9, 10, dhe 11, të këtij Udhëzimi Administrativ janë të bazuara në çmimet aktuale të tregut dhe janë siguruar nga informatat e grumbulluara të shitjeve e të gjitha kategorive të kafshëve, të lira nga sëmundjet nëpër tregjet e kafshëve në Republikën e Kosovës.
2. Të dhënat e shitjes së kafshëve grumbullohen çdo vit për të mbështetur tabelat e vlerësimit dhe çmimet e vendosura në tabelat e lartcekur.

Neni 15

Analiza e të dhënave statistikore

Për çdo vit kalendarik analizohen të dhënat statistikore të çmimit të shitjeve për periudhën 12 mujore për t'i mundësuar Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë që të kalkuloj çmimin mesatar të tregut për secilën kategori të llojit të kafshëve që kompensohen.

Neni 16

Asgjësimi i kafshëve për shkak të sëmundjeve infektive dhe kompensimi

1. Kompensimi i dëmit, për asgjësimin e kafshëve për shkak të sëmundjeve infektive nga neni 5, i këtij Udhëzimi Administrativ, do të bëhet vetëm për kafshët që asgjësohen nga Autoriteti Kompetent, përkatësisht Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, dhe të njëjtat janë identifikuar dhe regjistruara sipas legjislacionit në fuqi.
2. Çmimi për kompensim sipas këtij Udhëzimi Administrativ vlen për periudhën një vjeçare.
3. Afati rrjedhë nga data e nënshkrimit të këtij Udhëzimi Administrativ nga Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,.
4. Pas skadimit të periudhës prej një (1) viti, Udhëzimi Administrativ me çmime i nënshtrohen shqyrtimit dhe në rast nevojë revidimit dhe harmonizimit të tyre me çmimet e tregut.

Neni 17

Dokumentacioni dhe afatet kohore për kompensim

1. Për realizimin e kompensimit për kafshët e infektuara dhe të asgjësuar nga sëmundjet infektive, lënda duhet të përmbajë dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1. Procesverbalin e inspektorit nga vendi i ngjarjes – ferma;
 - 1.2. Rezultatin e analizave laboratorike nga LUV;
 - 1.2. Dëshmi mbi rezultatin e Testit të TBC;
 - 1.4. Vendimin e inspektorit për asgjësim;
 - 1.5. Vlersimin e komisionit për kompensimin e dëmit fermerit;
 - 1.6. Llogarinë Bankare të pronarit;
 - 1.7. Kopjen e letërnjoftimit,
 - 1.8. Vendimin e Drejtorit Ekzekutiv të AUV-së për kompensim;
 - 1.9. Kërkesën nga njësia përkatëse -SSHK për realizimin e pagesës.

2. Eliminimi ose groposja e kafshëve bëhet:

2.1.brenda 30 ditëve, për kafshët e rezultuara të infektuara gjatë kontrollit të tyre për brucelozë;

2.2.brenda 30 ditëve për kafshët e rezultuara të infektuara gjatë kontrollit të tyre për tuberkuloz;

2.3. menjëherë pas konfirmimit zyrtar në rastin e sëmundjes së Tërbimit;

2.4.menjëherë në rastin kur dyshohet dhe është raportuar zyrtarisht nga pronari i kafshës tek veterineri zyrtar, se ngordhja është shkaktuar nga sëmundja e plasjes.

3. Afati për asgjësimin e kafshëve është jo më gjatë se 30 (tridhjetë ditë) nga data e konfirmimit të sëmundjes.

4. Afati për kompletimin e lëndës me dokumentacionin përkatës është jo më gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e asgjësimit.

5. Afati i përgatitjes së vendimit nga zyra ligjore për kompensim, është jo më gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e pranimit në kopje fizike të lëndës, nëse lënda është e kompletuar nga inspektori.

6.Afati i pagesës 30 ditë nga pranimi i vendimit.

Neni 18

Mos kompensimi

1. Nuk dëmshpërblehen kafshët për të cilat pronari, nuk respekton nenin 27 të Ligjit për Veterinari, pronari mbajtësi dhe tregtari nëse nuk:

1.1. respektojnë obligimet që rrjedhin nga Ligji i Veterinarisë për sa i përket sëmundjeve ngjitëse dhe të zbatojë rregullat që ndërlidhen me to. Këta persona nuk bashkëpunojnë dhe asistojnë në kontrollin e sëmundjeve infektuese dhe ngjitëse dhe në deklarimin dhe lajmërimin në AUV të çdo dyshim për cilën do sëmundje ngjitëse nga lista e Programit të Parë; duke përfshirë detyrimin për ndalesat në lëvizje të kafshëve dhe njerëzve, therjen e kafshëve, shkatërrimin e produkteve shtazore, ushqimet e kafshëve dhe pajisjeve dhe pastrimin e dezinfektimin e objekteve, materialit dhe pajisjeve përcjellëse;

1.2. identifikojnë dhe regjistrojnë kafshët dhe deklarojnë lëvizjen e kafshëve për të cilën ata janë përgjegjës;

1.3. deklarojnë dhe lajmërojnë AUV për çdo dyshim për shfaqjen e ndonjë sëmundjeje nga lista e Programit të Dytë, të cilat janë objekt i programit të Kosovës për çrrënjosje të sëmundjes; dhe nuk respektojnë obligimet e vëna nga AUV për sa i përket dyshimit të shfaqjes së sëmundjeve nga Lista e Programit të Dytë që janë objekt i programit të Kosovës për çrrënjosje, duke përfshirë obligimet sa i përket kufizimeve të lëvizjes së kafshëve, therjes së kafshëve, shkatërrimit të produkteve shtazore, ushqimeve të kafshëve dhe pajisjeve, dhe pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve, materialeve relevante dhe pajisjeve;

1.4. plotësojnë kushtet për sa i përket importit të kafshëve të gjalla, operatorët e jashtëm me modelet përkatëse të certifikatave, të cilat përdoren për sa i përket llojeve të ndryshme të kafshëve të gjalla,

sëmundja në kafshë shfaqet gjatë importit ose gjatë karantinë së kafshëve të importuara dhe kur pronari është vetë fajtor për shpërthimin e sëmundjes, duke blerë kafshë të sëmura ose të dyshimta, të pashoqëruara me certifikatë veterinarë;

1.5. veprojnë në përputhje me pezullimin ose tërheqjen e çfarëdo aprovimi zyrtar nga ana e zyrtarëve të AUV, në bazë të rezultateve të inspektimit të kryer nga zyrtarët e tillë;

1.6. respektojnë periudhën e tërheqjes nga shitja dhe përdorimi i kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, sipas dispozitave të këtij Ligji të veterinarisë – urdhëresës nga zyrtarët e AUV-it

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 19 Zbatimi

Kompensimi i dëmit të përcaktuar sipas këtij Udhëzimi Administrativ – fermerëve të kafshëve të cilat asgjësohen për shkak të prezencës së sëmundjeve infektive do të bëhet nga data 27 mars 2024.

Neni 20 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (MBPZHR)-NR.08/2023 për vlerësimin dhe kompensimin e kafshëve të asgjësuar për shkak të sëmundjes infektive të datës 31.07.2023.

Neni 21 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

